



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 18.04.2023

Nr: 57

Ora: 17:00

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 49, DATË 17.04.2023 TË DEPOZITUAR NGA "PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 18.04.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: "Partia Demokratike e Shqipërisë", përfaqësuar nga z. Indrit Sefa

PALË E INTERESUAR: "Partia Socialiste e Shqipërisë", përfaqësuar nga z. Andi Skënderi

OBJEKT: 1. Shfuqizimi i vendimit nr. 366, datë 15.04.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokratike dhe verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qerim Ismail ismailaj, kandidat për kryetar të bashkisë Mallakastër i propozuar nga "Partia

Socialiste e Shqipërisë” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

2. Ndalimi i kandidimit të kandidatit për kryetar bashkie të Mallakastrës shtetasit Qerim Ismail Ismailaj të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 49 regj., datë 17.04.2023. Në mbledhjen e datës 18.04.2023, ora 17:00, pas relatimit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nr. 49 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi është paraqitur në formën e kërkuar nga KQZ, dhe brenda afatit ligjor të parashikuar.

Për sa i përket legjitimitit të subjektit ankues, KAS çmon se subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë” (PD) ka qenë palë në procesin administrativ të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili me vendimin nr. 366, datë 15.04.2023 është shprehur për themelin e kërkesës së PD-së drejtuar KSHZ-së.

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 49, datë 17.04.2023, të paraqitur nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 19.04.2023, ora 13:30.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Elvis **ÇEFA** - **Relator**

Elvin **LAKO** - **Anëtar**

Ilirjan **RUSMALI** - **Anëtar**

Ledio **BRAHO** - **Anëtar**

Koli **BELE** - **Anëtar**